



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 72, datë 24.07.2019

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË Z. BESNIK MUÇI NË VENDIN VAKANT PËR
GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare/Relatore
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, **z. Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës 24.07.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI PËR GJYQTAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Z. Besnik MUÇI,

OBJEKTI:

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të z. Besnik Muçi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares të Këshillit, **znj. Arta Marku**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*”, Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Sokol Berberi.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z.Besnik Muçi.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj.Arta Marku.

7. Z.Besnik Muçi, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Besnik Muçi, gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

8. Në datën 08.04.2019, kandidati Besnik Muçi është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

9. Në datën 12.04.2019, kandidati Besnik Muçi ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatit.

10. Duke qenë se kandidati Besnik Muçi është prokuror, ai është njëherazi edhe subjekt i rivlerësimit kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për rrjedhojë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për sa i përket vlerësimit dhe kontrollit të pasurisë dhe të figurës, merr parasysh konkluzionet e realizuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili, me Vendimin nr. 58, datë 01.08.2018 ka vendosur: “*Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, me funksion Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë*”.

11. Ndërkohë, Komisioneri Publik ka paraqitur ankim ndaj vendimit të sipërcituar të KPK dhe çështja është në shqyrtim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

12. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 112 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Besnik Muçi për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

13. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Besnik Muçi.

14. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Besnik Muçi në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

15. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr.8577/2000, neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75, 87, 94 dhe 104 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, meqenëse sipas vlerësimit paraprak *nuk rezultojnë gjetje të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit*, është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm duke e dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

16. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 24.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z. Besnik Muçi, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

17. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Besnik Muçi.

18. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

19. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 24.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

20. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

21. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e

Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Besnik Muçi.

22. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtrori se, në kushtet kur vendimi i dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është ankimuar nga ana e Komisionerit Publik, vendimmarrja e KED duhet të pezullohet deri në dhënien e vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili, në disa raste, ka ndryshuar edhe vendime konfirmimi në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

23. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatit Besnik Muçi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

24. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

25. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral. ”.

26. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mban parasysht se me Vendimin nr. 58, datë 01.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit Besnik Muçi, është konfirmuar në detyrë. Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjekteve të rivlerësimit merren në përfundim të hetimit dhe shqyrtimit të gjetjeve për të tre komponentët e kontrollit: pasurinë, figurën (integritetin) dhe aftësitë profesionale.

27. Gjithashtu, edhe lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, Këshilli i Emërimeve në mban parasysht arsyetimet dhe përfundimet përkatëse të Vendimit nr. 58, datë 01.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi.

28. Megjithatë, në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Besnik Muçi ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, parashikuar në Ligjin nr. 45/2015. Veprimet e verifikimit për këtë qëllim realizohen nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe nuk janë objekt hetimi dhe vendimmarrje nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Formularin e plotësuar nga kandidati, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

29. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kushti i parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të mbajë parasysht Vendimin nr. 58, datë 01.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në të cilin nuk është konstatuar asnjë shkelje lidhur me kontrollin e integritetit.

30. Për rrjedhojë, lidhur me kushtet ligjore të kandidimit të lidhura me figurën (integritetin) e kandidatit, në zbatim të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit.

31. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 199, nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Besnik Muçi në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si edhe informacione të kërkuara nga institucione publike ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

32. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Besnik Muçi ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1995 si “Jurist”, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidati Besnik Muçi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

33. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Besnik Muçi ka ushtruar veprimtari profesionale si :

a) Jurist dhe Oficer i Policisë Gjyqësore, Dega e Doganës Pogradec, për periudhën, dhjetor 1995- shtator 1997.

b) Avokat, me nr. Liçense Profesionale 803, Dhoma e Avokatisë Korçë, për periudhën dhjetor 1997 - shtator 1999.

c) Stazhi Profesional i Shkollës së Magjistraturës, Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, shtator 2001 janar 2002, dhe më pas i komanduar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë, janar-tetor 2002.

ç) Prokuror, për periudhën tetor 2002 - prill 2007, pranë prokurorisë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

d) Nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, Drejtor i Drejtorisë kundër Krimit Financiar, në Departamentin e Hetimit të Krimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë, për periudhën Maj 2007 - Korrik 2008, pranë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

dh) Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për periudhën gusht 2008 e në vazhdim.

e) Drejtues (Komanduar) i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për periudhën shkurt – shtator 2013.

ë) Zëvendës Drejtues (Komanduar) i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për periudhën nëntor 2013- shkurt 2014.

f) Drejtues i Seksionit për veprat penale kundër personit, për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për periudhën Mars 2017 e në vazhdim.

g) Ekspert i Programit për Trajnimin Vazhdues të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të Shkollës së Magjistraturës, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë për periudhën, prej vitit 2009 deri në vitin 2018.

34. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën 33 më sipër, Këshilli konstaton se kandidati Besnik Muçi ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

35. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidati Besnik Muçi nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidati Besnik Muçi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

36. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, konstatohet se kandidati Besnik Muçi nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidati Besnik Muçi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

37. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga përmbajtja e Vendimit nr. 58, datë 01.08.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidatit, nga të dhënat e komunikuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë deri më tani, Këshilli konstaton se konstatohet se kandidati Besnik Muçi nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidati Besnik Muçi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

38. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Besnik Muçi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Besnik Muçi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Besnik Muçi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI

